

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
"Alb Investment Group " SHPK**

Ne Tirane, sot më date 08/05/2024 në selinë e shoqërise, me zyrë në adresën: <Rruga Abdyl Frasheri, Vesa Center, Kati 3, hyrja 16, Tiranë u paraqit personalisht ortaku themelues si më poshte: Z.Bledar Rakipaj, shtetas Shqiptar, atësia Shkelqim, lindur më 30-04-1991 në Shkoder dhe banues ne Tirane, madhor, me zotësi të plote juridike dhe per të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim me Nr. Personal J10430068C,

I cili harton këtë Akt Themelim të Shoqërisë "Alb Investment Group" SHPK, mbështetur ne ligjin 9901, date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007 Për Qëndren Kombetare të Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si më poshte:

KREU I

**Neni 1
Krijimi**

Shoqeria " Alb Investment Group " SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptarë, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqeria").

**Neni 2
Personaliteti iuridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qëndrën Kombëtare te Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqeria " Alb Investment Group " shpk. është një shoqëri, që themelohet nga ortaku i vetëm Z. Bledar Rakipaj i cili përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij ne kapitalin themeltar.

**Neni 3
Selia**

Shoqëria e ka selinë në Rruga Abdyl Frasheri, Vesa Center, kati 3, hyrja 16 ,Tirane. Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyrë përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut/Ortakëve te Shoqerise.

**Neni 4
Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarise së kësaj shoqërie është:

Kryerjen e aktivitetit ne ndertimet civile, industriale, infrastrukture, ushtarake etj., si per llogari te vet ashtu dhe per te tretet, ku perfshihen ndertime pallatesh banimi, godina social-kulturore, komplekse industriale, ndertimet rrugore, hekurudha, porte, aeroporte, ura dhe vepra arti, centrale elektrike, linja te tensionit te larte dhe te mesem, montim i artikujve të ndërtimit, elektrike, panele diellorë, impiante eloiqe, impiante

elektrike, transformatorë. ujesjellesa, kanalizime, impiante te pastrimit, sinjalistike rrugore, punime topogjeodezike etj; Shfrytezim karrierash lumore dhe malore, prodhim inertesh, llaçi, betoni, parafabrikatesh, materialesh asfaltike, materialesh te tjera te nevojshme ne pergjithesi dhe per tregtimin e tyre per kryerjen e punimeve te ndertimit ne pergjithesi si dhe tregtimin e tyre; Punime inxhinierike projektimi, duke perfshire por pa u kufizuar ne vepra urbane, arkitekture, punime ndertimi, instalimi, pune hidraulike, punime rrugore dhe hekurudhore, ura dhe vepra arti, inxhinieri topografike dhe hidrologjike, inxhinieri, studime gjeologjike, pune inxhinierike te impianteve te prodhimit dhe transemtimit te energjise etj. Pjesemarrje ne tendera te te gjitha llojeve si dhe marrja persiper e projekteve te ndertimit vetem ose ne bashkepunim me çdo person fizik ose juridik nepermjet komisionit direkt per shtetin, organizatat publike ose private, dhe çdo organizate tjeter te sektorit publik duke perfshire dhe organet e qeverisjes vendore; Kryerjen e te gjitha veprimeve tregtare, industriale dhe financiare mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, etj. Punime civile per rikualifikim urban, Transport te mallrave brenda vendit me mjete jashte norme per llogari te vete.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 leke (njëmijë lekë). a) Ortaku Bledar Rakipaj është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1.000 lekë, që përbën 100% te kapitalit themeltar.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo te drejta). Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shperblimin e dëmit te shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7 Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave

Kuotat e kapitalit, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësive mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagësës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk për kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontrates. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmeria e kalimit të titullit të pronësive mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e Biznesit ose të publikimit të kontrates apo të kalimit të titullit.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi vendimmarrës

Asambleja e Ortakut/Ortakëve të vetëm është organi i vetëm vendimmarës i shoqërisë. Asambleja e Ortakut/Ortakëve të vetëm është organi i vetëm vendimmarës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja Ortakut/Ortakëve të vetëm është pëëgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë

për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kesaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ccurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfagësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Kreditimin në çfaredo bankë apo institucion financiar kreditor.
- n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamble të përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator Z. Bledar Rakipaj, shtetas Shqiptar, atesia Shkelqim, lindur më 30-04-1991 në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim me Nr. Personal J10430068C sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripertëritje. Asambleja e ortakut/ortakëve të vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratori shkarkohet nëse eivkata në shkëlqim të ligjit me kërkesë të çdonjerit prej ortakëve. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administratori i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë të detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë: bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së
- d) përgatit dhe nënshkruajë veprimtarinë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojë përpara asamblesë së ortakut/ortakëve të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligje dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Taksave, Zyrrave të Qeverisjes Vendore, Zyrrave të Punes, Autoriteteve Doganore, etj., në të gjitha Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, tërheqje, transferime, etj., përpara Zyrrave të Tatimit rrethanat me përjashtim të kompetencave ashtu siç janë të shprehura në ligjet dhe në statutet e shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve që janë përputhur me objektin e saj.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen për nen nga Ortaku i shoqërisë tregëtare " Alb Investment Group "shpk, dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË
" Alb Investment Group " SHPK

Bledar Rakipaj

Bledar Rakipaj

